



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Udhëzues Pune i Zyrës Administrative në lidhje me të paraburgosurit

Vizitat dhe Komunikimet e Mbrojtësve

Miratuar nga:	Administratorja, Dhomat e Specializuara të Kosovës
Data e miratimit:	23 shtator 2020
Data e hyrjes në fuqi:	23 shtator 2020
Zëvendëson:	KSC-BD-10
Numri:	KSC-BD-10-Rev1

Përmbajtja

KREU I	DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	2
NENI 1	QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI	2
NENI 2	PËRKUFIZIME	3
NENI 3	ZBATIMI	4
NENI 4	PARIME TË PËRGJITHSHME	4
NENI 5	MBROJTJA E TË DHËNAVE	4
NENI 6	NJOFTIMI PËR KAKTIMIN OSE EMËRIMIN E MBROJTËSIT DHE MIRATIMIN E EKIPIT TË MBROJTËSIT	4
NENI 7	SHPENZIMET	5
NENI 8	E DREJTA E PËRDORIMIT TË MATERIALEVE TË MBROJTJES DHE RUAJTJA E TYRE	5
KREU II	VIZITAT	5
NENI 9	DISPOZITA THEMELORE	5
NENI 10	KONTROLLET E SIGURISË	6
NENI 11	SENDET E SHKËMBYERA GJATË VIZITAVE	6
KREU III	KOMUNIKIMET	6
NENI 12	THIRRJET TELEFONIKE	6
NENI 13	LETËRKËMBIMI	7
KREU IV	KUFIZIMET	7
NENI 14	KUFIZIME TË PËRGJITHSHME	7
NENI 15	KUFIZIME TË PËRKOSSHME	8
NENI 16	MASAT URGJENTE TË SIGURISË	9
NENI 17	KONTROLLIMI I LETËRKËMBIMIT PËR SENDE TË NDALUARA	9
NENI 18	RISHIKIMI	10
KREU V	DISPOZITË PËRFUNDIMTARE	10
NENI 19	NDRYSHIMET	10

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Në bazë të rregullës 63 të Rregullores së Paraburgimit, Administratorja ka miratuar këtë Udhëzues Pune për Vizitat dhe Komunikimet e Mbrojtësve ('Udhëzuesi i Punës'), me qëllim lehtësimin e vizitave dhe të komunikimeve ndërmjet të paraburgosurit dhe mbrojtësit të vet gjatë kohës që i paraburgosuri është në objektin e paraburgimit.
2. Ky Udhëzues Pune nuk zbatohet për vizitat dhe komunikimet personale të të paraburgosurit me anëtarë të familjes dhe persona të tjerë, që rregullohen nga Udhëzuesi i Punës për Vizitat dhe Komunikimet, miratuar veças në bazë të rregullës 63 të Rregullores së Paraburgimit.

3. Ky Udhëzues Pune nuk ndikon në urdhrat ose vendimet e panelit kompetent të lëshuara në bazë të rregullës 56 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave dhe është në varësi të këtyre urdhrave ose vendimeve.

Neni 2 Përkufizime

Krahas përkufizimeve të rregullës 2 të Rregullores së Paraburgimit, zbatohen edhe përkufizimet e mëposhtme:

Zyra e administrimit	Zyra e administrimit e Njesisë së Paraburgimit të Zyrës Administrative;
Komunikim	Çdo thirrje telefonike apo letërkëmbim ndërmjet të paraburgosurit dhe mbrojtësit gjatë kohës që i paraburgosuri është në objektin e paraburgimit;
Letërkëmbim	Çdo postë hyrëse apo dalëse, përfshirë pakot dhe sendet e mbyllura, ndërmjet një të paraburgosuri dhe mbrojtësit gjatë kohës që i paraburgosuri është në objektin e paraburgimit;
Bashkëmbrojtës	Një person i zgjedhur për të vepruar si bashkëmbrojtës, në përputhje me pjesën 18 të Direktivës për Mbrojtësit;
Mbrojtës	Mbrojtësi i emëruar ose i caktuar nga Administratori për një të paraburgosur, në përputhje me Direktivën për Mbrojtësit;
Shefi i Zyrës së Mbrojtjes	Kreu i Zyrës së Mbrojtjes, njësi e Zyrës Administrative e parashikuar në nenin 34(7) të Ligjit dhe rregullën 23(6) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave;
Rregullorja e Ndhmës Juridike	Rregullat për caktimin e mbrojtësve në kuadër të ndihmës juridike, miratuar nga Administratori në bazë të nenit 34(6) dhe (7), të Ligjit;
Vizitë	Çdo kontakt personal ndërmjet të paraburgosurit dhe mbrojtësit gjatë kohës që i paraburgosuri është në objektin e paraburgimit, me ose pa kontakt fizik.

Neni 3 Zbatimi

Ky Udhëzues Pune interpretohet dhe zbatohet në përputhje me Ligjin, Rregulloren e Procedurës dhe të Provave dhe Rregulloren e Paraburgimit.

Neni 4 Parime të përgjithshme

1. Në përputhje me të drejtën e të paraburgosurve për të pasur kohë dhe mjete e mundësi të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së vet dhe për të komunikuar me mbrojtësit e tyre sipas nenit 21 të Ligjit, të paraburgosurve u jepet mundësi e mjaftueshme të kenë vizitë dhe të komunikojnë lirisht, në mënyrë konfidenciale dhe pa censurë me mbrojtësit e tyre. Të paraburgosurit kanë të drejtë të përdorin në mënyrë të arsyeshme mjediset dhe pajisjet e komunikimit që ofrohen për këtë qëllim.
2. Vizitat dhe komunikimet midis të paraburgosurve dhe mbrojtësve janë të privileguara. Konfidencialiteti i vizitave dhe komunikimeve midis të paraburgosurve dhe mbrojtësve nuk kufizohet, përveçse në rrethana të jashtëzakonshme kur kufizimet janë të domosdoshme për arritjen e qëllimit legjitim të parandalimit të një kërcënimi të menjëhershëm ndaj jetës së personit, ose për të parandaluar keqpërdorimin e konfidencialitetit të komunikimeve mbrojtës-klient për kryerjen e një krimi dhe këto kufizime janë proporcionale në raport me qëllimin legjitim të lartpërmendur.

Neni 5 Mbrojtja e të dhënave

1. Duke iu referuar rregullës 64 të Rregullores së Paraburgimit, të gjitha të dhënat personale të mbledhura sipas këtij Udhëzuesi Pune, klasifikohen si rreptësisht konfidenciale.
2. Të dhënat e privileguara të përmendura në paragrafin 1, fshihen ose asgjësohen brenda gjashtë (6) muajsh pas mbledhjes së tyre, përveçse kur këto të dhëna mbahen dhe i jepen panelit kompetent, ose kur paneli kompetent urdhëron ndryshe.

Neni 6 Njoftimi për caktimin ose emërimin e mbrojtësit dhe miratimin e ekipit të mbrojtësit

1. Pa vonesë pas pranimit të një paraburgosuri në objektin e paraburgimit sipas rregullës 10 të Rregullores së Paraburgimit, shefi i Zyrës së Mbrojtjes e informon të paraburgosurin për procesin e angazhimit të një mbrojtësi të zgjedhur prej vetë të paraburgosurit, në përputhje me Direktivën për Mbrojtësit dhe, nëse është e zbatueshme, në përputhje me Rregulloren e Ndihmës Juridike të Dhomave të Specializuara.
2. Vizitat dhe komunikimet me shefin e Zyrës së Mbrojtjes nuk janë të privileguara dhe mbulohen nga Udhëzuesi i Punës për Vizitat dhe Komunikimet.
3. Me caktimin ose emërimin e mbrojtësit, shefi i Zyrës së Mbrojtjes informon shefin e paraburgimit për emrin dhe të dhënat e kontaktit të mbrojtësit.
4. Shefi i Zyrës së Mbrojtjes e informon shefin e paraburgimit për të gjithë anëtarët e ekipit të mbrojtësit dhe të dhënat e tyre të kontaktit, pas miratimit të tyre në përputhje me pjesën 18 të Direktivës për Mbrojtësit. Vetëm anëtarët e ekipit të miratuar sipas pjesës 18 të Direktivës për mbrojtësit, përfshirë përkthyesit, mund ta shoqërojnë mbrojtësin kur viziton një të paraburgosur.

5. Bashkëmbrojtësi ka të njëjtat të drejta si mbrojtësi për vizitat dhe komunikimet e privileguara, përmendur në Kreun II – IV të këtij Udhëzuesi Pune.

Neni 7 Shpenzimet

Shpenzimet për komunikimet me mbrojtësit dhe bashkëmbrojtësit janë përgjegjësi e të paraburgosurit. Nëse konstatohet se i paraburgosuri është plotësisht apo pjesërisht i varfër sipas Rregullores së Ndhmës Juridike, Administratori mund të vendosë që shpenzimet e arsyeshme për komunikime me mbrojtësin dhe bashkëmbrojtësin të paguhen nga Dhoma e Specializuarë.

Neni 8 E drejta e përdorimit të materialeve të mbrojtjes dhe ruajtja e tyre

1. Të paraburgosurit kanë të drejtë të përdorin dhe lejohen të mbajnë në zotërim materiale për përgatitjen e mbrojtjes së tyre, siç përcaktohet në rregullën 26 të Rregullores së Paraburgimit. Të paraburgosurve u vihet në dispozicion hapësirë e mjaftueshme për ruajtjen e këtyre materialeve në objektin e paraburgimit.
2. Duke u kushtuar rëndësinë e duhur kushteve të zakonshme dhe të arsyeshme të mbajtjes në paraburgim dhe pa cenuar të drejtën e të paraburgosurit për kohë dhe mjete e mundësi të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së vet, shefi i paraburgimit mund të vendosë kufizime të arsyeshme për përdorimin prej të paraburgosurit të materialeve të përmendura në paragrafin 1, varësisht nga plani ditor i punës në objektin e paraburgimit dhe disponueshmëria e personelit, mjediseve, apo pajisjeve.

KREU II VIZITAT

Neni 9 Dispozita themelore

1. Vizitat e mbrojtësve kryhen brenda rrezes së shikimit, por jo brenda rrezes së dëgjimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të oficerëve të paraburgimit.
2. Shefi i paraburgimit mban një regjistër ku shënon të gjithë vizitorët, përfshirë emrin e të paraburgosurit, emrin dhe adresën e vizitorit, dhe orën e datën e vizitës.
3. Vizitat e mbrojtësve bëhen në marrëveshje paraprake me shefin e paraburgimit për sa i përket orarit dhe kohëzgjatjes së tyre. Mbrojtësit mund të kontaktojnë me zyrën e administrimit për planifikimin e vizitës.
4. Anëtarë të ekipit të mbrojtësit, të përmendur në nenin 6.4 të këtij Udhëzuesi Pune, mund ta shoqërojnë mbrojtësin gjatë kohës që viziton të paraburgosurin.
5. Kur planifikon një vizitë sipas paragrafit 3 të këtij neni, mbrojtësi e njofton paraprakisht shefin e paraburgimit për një vizitë të shoqëruar sipas paragrafit 4 të këtij neni. Vizitat e shoqëruara trajtohen si të privileguara në të njëjtën masë si vizitat e tjera të mbrojtësve në bazë të këtij Udhëzuesi Pune.

Neni 10 Kontrollet e sigurisë

1. Pas njoftimit në përputhje me nenin 6 të këtij Udhëzuesi Pune, shefi i paraburgimit informon burgun për miratimin e vizitave të rregullta të mbrojtësit.
2. Mbrojtësit duhet të paraqesin një dokument të vlefshëm identiteti me fotografi, që është i pranueshëm nga burgu dhe objekti i paraburgimit.
3. Për hyrjen në burg dhe në objektin e paraburgimit, mbrojtësi duhet të përmbushë kushtet e sigurisë të burgut dhe objektit të paraburgimit dhe të japë pëlqimin për t'u kontrolluar. Gjatë kontrolleve respektohet konfidencialiteti i komunikimit mbrojtës-klient. Kontrollet në burg kryhen në përputhje me legjislacionin e shtetit pritës. Kontrollet në objektin e paraburgimit kryhen në përputhje me udhëzimet me shkrim të shefit të paraburgimit mbi kushtet e sigurisë për të hyrë në objektin e paraburgimit dhe mbrojtësit i jepet një kopje e këtyre udhëzimeve përpara se të japë pëlqimin për t'u kontrolluar. Mbrojtësi mund ta tërheqë pëlqimin e vet për kontrollin në çfarëdo kohe.
4. Në qoftë se e tërheq pëlqimin e vet për çfarëdo kontrolli sigurie, mbrojtësi i refuzohet hyrja në burg dhe në objektin e paraburgimit.

Neni 11 Sendet e shkëmbyera gjatë vizitave

1. Gjatë vizitës për përgatitjen e mbrojtjes, mbrojtësi mund t'i japë të paraburgosurit shkresa, si dhe CD-ROM ose DVD që përmbajnë komunikime konfidenciale midis mbrojtësit dhe klientit, materiale të punës së kryer, dokumente që lidhen me çështjen gjyqësore dhe materiale të tjera të përmendura në rregullën 25 të Rregullores së Paraburgimit dhe në nenin 8.1 të këtij Udhëzuesi Pune. Gjithashtu edhe mbrojtësi mund të marrë dokumente që lidhen me çështjen gjyqësore nga i paraburgosuri gjatë vizitës.
2. Materialet për përgatitjen e mbrojtjes që shkëmbehen me të paraburgosurin gjatë vizitës, trajtohen si letërkëmbim në përputhje me nenin 13 dhe nenin 17 të këtij Udhëzuesi Pune.
3. Në bazë të nenit 14.1 të këtij Udhëzuesi Pune dhe pa cenuar të drejtën e të paraburgosurit për kohë e mjete e mundësi të mjaftueshme në përgatitjen e mbrojtjes së vet, Administratori ose shefi i paraburgimit mund të vendosë kufizime të përgjithshme mbi sendet e sjella në vizita, ose mbi shkëmbimin e drejtpërdrejtë të materialeve gjatë vizitave.

KREU III KOMUNIKIMET

Neni 12 Thirrjet telefonike

1. Të paraburgosurit mund të përdorin linja telefonike të mbrojtura dhe jo të mbrojtura.
2. Të paraburgosurit mund t'u telefonojnë mbrojtësve të tyre nëpërmjet linjës së mbrojtur telefonike. Shefi i paraburgimit mund t'i lejojë të paraburgosurit që të pranojnë thirrje telefonike prej mbrojtësve vetëm në rrethana të jashtëzakonshme.
3. Shefi i paraburgimit verifikon dhe miraton paraprakisht numrat e kontaktit të mbrojtësit për të shmangur keqpërdorimin e linjës së mbrojtur telefonike.

4. Shefi i paraburgimit mund të vendosë kufizime të arsyeshme në lidhje me orarin, numrin dhe kohëzgjatjen e thirrjeve bazuar në planin ditor të punës të objektit të paraburgimit dhe disponueshmërinë e pajisjeve telefonike. Në rrethana të jashtëzakonshme, shefi i paraburgimit mund ta lejojë një të paraburgosur që të bëjë thirrje telefonike edhe në orar tjetër.
5. Shefi i paraburgimit mban një regjistër ku shënon të gjitha thirrjet telefonike dalëse apo hyrëse, përfshirë dhe emrin e të paraburgosurit, numrin e telefonit, datën dhe orën e thirrjes telefonike, si dhe çfarëdo të dhëne tjetër që shefi i paraburgimit e gjykon të rëndësishme. Regjistrat e thirrjeve telefonike mbahen për një periudhë prej jo më shumë se tetë (8) muajsh nga krijimi i tyre, në përputhje me afatet e Dhomave të Specializuara për mbajtjen e të dhënave, përmendur në rregullën 64 të Rregullores së Paraburgimit. Periudha e lartpërmendur mund të zgjatet me udhëzim të Administratorit.
6. Udhëzuesi i Punës për Vizitat dhe Komunikimet trajton përdorimin e linjave telefonike jo të mbrojtura.

Neni 13 Letërkëmbimi

1. Letërkëmbimi konfidencial i të paraburgosurit me mbrojtësin nuk lexohet. Letërkëmbimi dorëzohet ose postohet pa vonesë, përveçse kur përmban sende të ndaluara sipas rregullës 25 të Rregullores së Paraburgimit dhe nenit 17 të këtij Udhëzuesi Pune.
2. Shefi i paraburgimit mban një regjistër ku shënon të gjithë postën e dërguar ose të marrë nga i paraburgosuri, duke përfshirë marrësin, dërguesin (nëse dihet), datën e vulës postare ose të faturës, si dhe çdo të dhënë tjetër të rëndësishme sipas gjykimit të shefit të paraburgimit.
3. Duke mbajtur parasysh si duhet paragrafin 1, i gjithë letërkëmbimi iu nënshtrohet kontrolleve të sigurisë në objektin e paraburgimit dhe, sipas rastit, të burgut, përfshirë përdorimin e aparateve me rreze Röntgen dhe pajisjeve të tjera kontrolluese, në përputhje me rregullën 25 të Rregullores së Paraburgimit.
4. Posta e adresuar për mbrojtësin dërgohet vetëm në adresën që mbrojtësi i ka dhënë shefit të Zyrës së Mbrojtjes në përputhje me nenin 6, në të kundërt ajo i kthehet përsëri e pahapur të paraburgosurit.

KREU IV KUFIZIMET

Neni 14 Kufizime të përgjithshme

1. Rregullorja e Paraburgimit, ky Udhëzues Pune dhe çfarëdo udhëzuesish pune apo udhëzimesh të miratuara ose të lëshuara në bazë të rregullës 4 të Rregullores së Paraburgimit, përcaktojnë kufizime të një natyre të përgjithshme për të gjithë të paraburgosurit që janë të domosdoshme në rrethanat e sigurisë së lartë në objektin e paraburgimit, ose që janë të domosdoshme për mbrojtjen e shëndetit të të paraburgosurve dhe të tjerëve.
2. Duke mbajtur parasysh si duhet kushtet e zakonshme dhe të arsyeshme të mbajtjes në paraburgim, shefi i paraburgimit mund të vendosë kufizime të arsyeshme për vizitat dhe komunikimet me

mbrojtësit, duke u bazuar në planin ditor të punës të objektit të paraburgimit dhe disponueshmërinë e personelit dhe të pajisjeve e mjediseve.

Neni 15 Kufizime të përkohshme

1. Administratori mund të vendosë përkohësisht kufizime të domosdoshme dhe proporcionale mbi konfidencialitetin e vizitave dhe komunikimeve të përshkruara në Kreun II dhe III, midis të paraburgosurit dhe mbrojtësit dhe cilitdo anëtar të ekipit të mbrojtësit, për arsye të jashtëzakonshme dhe vetëm në rrethanat e përshkruara në nenin 4.2 të këtij Udhëzuesi Pune. Para caktimit të kufizimeve të përkohshme, Administratori njofton panelin kompetent, të paraburgosurin dhe mbrojtësin për vendimin, sikurse përcaktohet në këtë nen.
2. Në bazë të nenit 4.2 të këtij Udhëzuesi Pune, në veçanti Administratori mund të vendosë ndër të tjera që përkohësisht të incizojë, dëgjojë, bëjë përmbledhje ose të transkriptojë:
 - a. vizitat e një mbrojtësi me të paraburgosurin për një periudhë jo më të gjatë se shtatë (7) ditë kalendarike të njëpasnjëshme e cila mund të zgjatet deri në shtatë (7) ditë shtesë kalendarike të njëpasnjëshme, nëse gjykohet e domosdoshme dhe proporcionale për vazhdimin e kufizimit të përkohshëm; dhe
 - b. biseda telefonike midis një paraburgosuri të caktuar dhe mbrojtësit për një periudhë jo më të gjatë se katërmëdhjetë (14) ditë kalendarike të njëpasnjëshme e cila mund të zgjatet deri në katërmëdhjetë (14) ditë shtesë kalendarike të njëpasnjëshme nëse gjykohet e domosdoshme dhe proporcionale për vazhdimin e kufizimit të përkohshëm.
3. Nëse, Administratori merr vendim për caktimin e kufizimeve të përkohshme, së paku njëzet e katër (24) orë para se kufizimet të hyjnë në fuqi, zbatohen hapat e mëposhtëm.
 - a. I paraburgosuri dhe mbrojtësi informohen me shkrim për vendimin dhe në një gjuhë që i paraburgosuri kupton;
 - b. I paraburgosuri dhe mbrojtësi informohen për arsyen e vendimit, përveçse kur arsyeja nuk mund të bëhet e ditur pa paragjykuar qëllimin legjitim të vendimit;
 - c. Administratori informon panelin kompetent për kufizimet e përkohshme dhe arsyet e këtyre kufizimeve; dhe
 - d. I paraburgosuri informohet për të drejtën e vet për paraqitje ankese kundër vendimit.
4. Kufizimet e përkohshme caktohen për një periudhë jo më të gjatë se sa është e domosdoshme për arritjen e qëllimit legjitim dhe shënohen në dosjen personale të paraburgosurit.
5. Ky nen nuk paragjykon kompetencën e shefit të paraburgimit për:
 - a. marrjen e masave urgjente të sigurisë në bazë të nenit 16 të këtij Udhëzuesi Pune;
 - b. bllokimin e letërkëmbimit për të verifikuar nëse ka sende të ndaluara në bazë të nenit 17 të këtij Udhëzuesi Pune; dhe
 - c. trajtimin e sendeve të ndaluara në përputhje me rregullën 25 të Rregullores së Paraburgimit.

Neni 16 Masat urgjente të sigurisë

1. Synimi i masave urgjente të sigurisë është të garantohen siguria dhe rregulli në objektin e paraburgimit, parandalimi i trazirave ose kryerjes së krimeve, mbrojtja e shëndetit, mirëqenies, sigurisë, të drejtave, ose lirive të tjerëve.
2. Në rast urgjence, nëse vlerëson se vendosja e menjëhershme e kufizimeve është e domosdoshme për realizimin e një prej synimeve legjitime të përmendura në paragrafin 1, shefi i paraburgimit mund:
 - a. t'i japë fund menjëherë, ose të ndërpresë vizitën, ose bisedën telefonike të mbrojtësit;
 - b. të çojë mbrojtësin, cilindo anëtar të ekipit të mbrojtësit ose të paraburgosurin në mjedise të veçuara në objektin e paraburgimit nëse është e domosdoshme dhe për atë që është e domosdoshme për garantimin e sigurisë së këtyre personave; dhe
 - c. të ndalojë përkohësisht vizitat dhe komunikimet e mbrojtësit, ose të kufizojë përkohësisht kohëzgjatjen e tyre për atë që është e domosdoshme, gjithsesi për një periudhë jo më të gjatë se tri (3) ditë kalendarike të njëpasnjëshme.
3. Shefi i paraburgimit e informon pa vonesë Administratorin për çdo masë urgjente të sigurisë të marrë sipas këtij neni dhe për arsyet përkatëse.
4. Nëse, për arsye urgjence, është e domosdoshme të veprohet menjëherë, një oficer i paraburgimit mund të marrë masa në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni dhe më pas informon shefin e paraburgimit, pa vonesë. Paragrafi 2 zbatohet *mutatis mutandis*.

Neni 17 Kontrollimi i letërkëmbimit për sende të ndaluara

1. Në rrethana të jashtëzakonshme, dhe duke mbajtur parasysh si duhet nenin 13.1 të këtij Udhëzuesi Pune, nëse ka arsye të dyshojë se letërkëmbimi me mbrojtësin përmban sende të ndaluara përcaktuar në rregullën 25 të Rregullores së Paraburgimit, shefi i paraburgimit bllokoi letërkëmbimin për ta kontrolluar për sende të ndaluara dhe e shënon bllokimin në regjistër në përputhje me nenin 13.2 të këtij Udhëzuesi Pune.
2. Me bllokimin e postës hyrëse:
 - a. shefi i paraburgimit njofton pa vonesë të paraburgosurin dhe mbrojtësin dhe ia dërgon postën të pahapur Administratorit; dhe
 - b. Administratori i kërkon mbrojtësit ta hapë atë në prani të Administratorit për të përcaktuar vetëm nëse posta përmban sende të ndaluara.
3. Me bllokimin e postës dalëse:
 - a. shefi i paraburgimit njofton pa vonesë të paraburgosurin dhe Administratorin; dhe
 - b. shefi i paraburgimit e hap postën dalëse në prani të të paraburgosurit për të përcaktuar vetëm nëse posta dalëse përmban sende të ndaluara.
4. Çdo send i ndaluar që zbulohet, konfiskohet ose asgjësohet në bazë të rregullës 25 të Rregullores së Paraburgimit.

Neni 18 Rishikimi

1. Një i paraburgosur të cilit i janë kufizuar vizitat dhe komunikimet me mbrojtësin në bazë të këtij Udhëzuesi Pune, mund t'i paraqesë ankesë ose kërkesë zyrtare për rishikim autoritetit përkatës, sikurse përcaktohet në Udhëzuesin e Punës për Ankesat.
2. Nëse ankesa e drejtpërdrejtë që i paraburgosuri i paraqet Administratorit, është në lidhje me vendimin e Administratorit për caktimin e kufizimeve të përkohshme sipas këtij Udhëzuesi Pune, Administratori duke anashkaluar Udhëzuesin e Punës për Ankesat, lëshon vendim për ankesën e drejtpërdrejtë brenda shtatë (7) ditësh nga marrja e ankesës me shkrim të paraburgosurit.

KREU V DISPOZITË PËRFUNDIMTARE

Neni 19 Ndryshimet

1. Ndryshimet e këtij Udhëzuesi Pune hyjnë në fuqi në datën e nënshkrimit të tyre.
2. Ndryshimet e këtij Udhëzuesi Pune nuk kanë fuqi prapavepruese.

Hagë, Holandë
23 shtator 2020

Dr. Fidelma Donlon
Administratore